FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 48	2000	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8721 datë 26.12.2000	Për një shtesë në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore"	2079
Ligj nr.8725 datë 26.12.2000	Për një ndryshim në ligjin nr.8636, datë 6.7.2000 "Për zonat e lira"	2079
Ligj nr 8726 datë 26.12.2000	Për mbulimin e detyrimeve të shtetit ndaj Bankës së Kursimeve sh.a. dhe rikapitalizimin e saj nëpërmjet emërtimit të bonove të thesarit	2080
Ligj nr.8727 datë 26.12.2000	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 13.12.2000 "Për përjashtimin nga TVSH-ja të gazit të lëngët e të pajisjeve që punojnë me gaz të lëngët dhe që përdoren për ngrohje dhe gatim"	2081
Vendim i KM nr.667, datë 15.12.2000	Për kalimin e rrugëve rurale në administrimin e këshillave të qarqeve	2082
Vendim i KM	Për krijimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të	

nr.671, datë 15.12.2000	verbërisë	2083
Vendim i KM nr.672, datë 15.12.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 776, datë 8.12.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike, ushtarake, të rëndësisë së veçantë"	2084
Vendim i KM Nr.678, datë15.12.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për drejtorinë e shërbimeve qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta"	2085
Vendim i KM nr.687, datë 15.12.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.723, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit"	2085
Vendim i KM nr.695, datë 20.12.2000	Për një ndryshim në vendimin nr.102, datë 5.3.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore"	2086
Vendim i KM nr.708, datë 21.12.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.206, datë 26.3.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve, në raste fatkeqësish"	2087
Vendim i KM nr.718, datë 21.12.2000	Për shpalljen pasuri kulturore të disa kalave dhe kështjellave	2087
Vendim i KM nr.725, datë 23.12.2000	Për regjimin e tranzitimit të duhanëve dhe cigareve	2088
Vendim i KM nr.727, datë 28.12.2000	Për caktimin e kufirit minimal të regjistrimit për TVSH-në	2089
Vendim i KM nr.728, datë 28.12.2000	Për ngritjen, përbërjen dhe detyrat e komisioneve të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në qarqe (prefektura)	2090
Vendim i KM nr.734, datë 28.12.2000	Për ngritjen, përbërjen dhe detyrat e zyrave të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki e komuna	2091
Vendim i KM nr.737, datë 28.12.2000	Për përcaktimin e termave dhe të kushteve të bonove të thesarit, për detyrimin e shtetit dhe për rikapitalizimin e Bankës së Kursimeve, sh.a	2093
Vendim i Gj.L.nr.1029	Me objekt: Shuarje e dënimit për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike dhe kalimit të paligjshëm të kufirit, parashikuar nga nenet 283/1 dhe 297 të Kodit Penal	2094

Vendim i GJ.K.nr.88	Me objekt: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.12, datë 15.12.1996, të Gjykatës së apelit Tiranë; nr.773, datë 2.6.1997, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.P-1, datë 9.2.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë	2101

L I G J
Nr.8721, datë 26.12.2000

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7710, DATË 18.5.1993 "PËR NDIHMËN DHE PËRKUJDESJEN SHOQËRORE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 3 pika 6 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993, pas fjalëve "… ose punojnë jashtë shtetit," shtohen fjalët "me përjashtim të përfitimeve, në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2856, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8725, datë 26.12.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8636, DATË 6.7.2000 "PËR ZONAT E LIRA"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Pika 3 e nenit 18 të ligjit nr.8636, datë 6.7.2000 "Për zonat e lira" shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2860, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr 8726, datë 26.12.2000

PËR MBULIMIN E DETYRIMEVE TË SHTETIT NDAJ BANKËS SË KURSIMEVE SH.A. DHE RIKAPITALIZIMIN E SAJ NËPËRMJET EMETIMIT TË BONOVE TË THESARIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 84 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Detyrimet e papaguara ndaj Bankës së Kursimeve sh.a, në shumën prej 7.607 milionë lekësh, paguhen nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit, me terma dhe kushte tregtare. Termat dhe kushtet e emetimit të bonove të thesarit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Mbulimi i humbjeve të akumuluara, pas zbritjes së fitimit, dhe rikapitalizimi i Bankës së Kursimeve sh.a., sipas bilancit të audituar, të datës 31.12.1999, për shumën prej 9.640 milionë lekësh paguhet nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit, me terma dhe kushte tregtare.Termat dhe kushtet e emetimit të bonove të thesarit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Garancia e Ministrisë së Financave për Ujëmbledhësin e Bovillës është e vlefshme sipas marrëveshjes së datës 22.11.1993; Ministria e Financave dhe Banka e Kursimeve sh.a., të zgjidhin, me marrëveshje ndërmjet tyre, përcaktimin e pagimit me këste nga Buxheti i Shtetit të kësaj shume deri në shlyerjen përfundimtare të këtij detyrimi, brenda vitit 2001.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.2853, datë 28.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8727, datë 26.12.2000

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.7, DATË 13.12.2000 "PËR

PËRJASHTIMIN NGA TVSH-JA TË GAZIT TË LËNGËT E TË PAJISJEVE QË PUNOJNË ME GAZ TË LËNGËT DHE QË PËRDOREN PËR NGROHJE DHE GATIM"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 13.12.2000 "Për përjashtimin nga TVSH-ja të gazit të lëngët e të pajisjeve që punojnë me gaz të lëngët dhe që përdoren për ngrohje dhe gatim".

Shpallur me dekretin nr.2861, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 667, datë, 15.12.2000

PËR KALIMIN E RRUGËVE RURALE NË ADMINISTRIMIN E KËSHILLAVE TË QARQEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 dhe 13, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rrjeti rrugëve rurale, i cili, sipas vendimit nr. 405, datë 8.1.1996, të Këshillit të Ministrave, është administruar nga ish-këshillat e rretheve, të kalojë në administrimin e këshillave të qarqeve.
2. Strukturat e njësive ekonomike (ndërmarrjet/sektorët e rrugëve rurale), të ngritura për administrimin e këtij rrjeti rrugor, në bazë rrethi, së bashku me objektet në përdorim, punonjësit, pajisjet, makineritë dhe fondet përkatëse, të kalojnë në përgjegjësi të këshillave të qarqeve.
3. Ngarkohen prefekturat, këshillat e qarqeve dhe kryetarët e këshillave të qarqeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 671, datë 15.12.2000

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT MJEKËSOR TË PËRCAKTIMIT TË VERBËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbërit", me propozimin e ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV), për përcaktimin e personave që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Komsioni e ka qendrën në Tiranë dhe është në varësi të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale. Numri, përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të përcaktohet nga ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. KMPV-ja kryen detyrat dhe ka të drejtat e përcaktuara për KMCAP-në, sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimin nga statusi i të verbërit"

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përfundojnë procedurat e kalimit të përgjegjësive nga KMCAP në KMPV. Ngarkohet drejtori i Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale të normojë dhe të kontrollojë procesin e kalimit të këtyre përgjegjesive.

4. Kriteret mjekësore, për përfitimin nga "statusi i të verbërit", janë të veçanta dhe përcaktohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe nga Ministria e Shëndetësisë.

5. Pagesa e mjekëve, anëtarë të komisionit, në bazë të pjesëmarrjes në çdo komision, i cili mblidhet jo më shumë se dy herë në muaj, të bëhet në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në vendimin nr. 393, datë 3.9.1992, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga pagesat për KMPV-në, të përballohen nga fondi i Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale.

7. Në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", bëhen ndryshimet si vijon:

a) "Kudo në vendim ku përmendet "KMCAP" (të rrethit përkatës) të zëvendësohet me "KMPV".

b) Paragrafi i parë, pika 3 të riformulohet:

"Shoqata e të verbërve të Shqipërisë lëshon librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996, e cila nuk është e njëjtë me librezën e anëtarësisë. Librezat e verbërisë jepen vetëm kur Kryesisë së Shoqatës të së Verbërve të Shqipërisë i vihen në dispozicion nga KMPV-ja, raportet mjekësore dhe dokumentacioni tjetër, i nevojshëm për çdo person.".

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 672, datë 15.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 766, DATË 8.12.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE, USHTARAKE, TË RËNDËSISË SË VEÇANTË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 8478, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i

Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 766, datë 8.12.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë të pikës 1, fjalët "....deri në dy vjet" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "....deri më 31.12.2001".

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Pagesën e gadishmërisë e përfitojnë 1160 punonjës të Kombinatit Mekanik në Poliçan, 100 punonjës të Uzinës së Lëndëve Plasëse në Mjekës, 70 punonjës të Uzinës Mekanike në Gramsh, dhe 20 punonjës të Uzinës së Pilave në Gramsh. Në rastet kur këta punonjës largohen për efekt të daljes në pension ose shkëpusin marrëdhëniet me ndërmarrjet për shkak të vendbanimit familjar ose për arsye të tjera, të mos zëvendësohen me punonjës të tjerë.".

3. Pika 4 ndryshohet si vijon:

"Rritja e masës së pagesës së këtyre punonjësve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës.".

4. Pika 6 ndryshohet si vijon:

"Periudha e pagesës së punonjësve, sipas këtij vendimi, vlerësohet periudhë sigurimi. Kontributet për sigurimet shoqërore për këta punonjës përballohen nga buxheti i shtetit.".

5. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

"Efektet financiare për pagesën dhe kontributet për sigurimet shoqërore të punonjësve të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 678, datë, 15.12.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 34, DATË 7.1.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE DHE TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 7582, datë 7.1.1992, "Për ndërmarrjet shtetërore" dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 7971, datë 26.7.1995, "Për prokurimin publik", me propozimin e kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave bëhen ndryshimet, si vijojnë:

a) Në shkronjën "c", të pikës 13 hiqet shprehja ".....apo në apartamentet e tyre.".

b) Shkronja "d" e pikës 13 shfuqizohet.

c) Pika 17 formulohet si vijon:

"Për kryerjen në kohë e me cilësi të të gjithë veprimtarisë së përcaktuar në këtë vendim, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare lejohet të blejë mallra dhe të kryejë shërbime me cilësi të lartë në tregun e brendshëm e të jashtëm, me procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë", përjashto këtu investimet, ndërsa për nevoja të domosdoshme lejohet të kryejë pagesa me lekë në dorë, deri në 200 000 lekë në ditë.".

ç) Pas pikës 17 të vendimit shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

"Shkronja "c" e pikës 4, të vendimit nr. 335, datë 23.6.2000, të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik", shfuqizohet".

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.687, datë 15.12.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.723, DATË 19.11.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994, "PËR STATUSIN E INVALIDIT""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", ndryshuar me ligjin nr.8052, datë 21.12.1995, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 3, në vendimin nr.723, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:
"Shuma mujore e rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve është 4 000 lekë".
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 567 mijë lekë në muaj dhe përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 695, datë 20.12.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.102, DATË 5.3.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË FUNKSIONARËVE POLITIKË DHE NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999, "Për statusin e deputetit", të paragrafit të parë të nenit 30 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" dhe të nenit 12 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996, "Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 6 e vendimit nr.102, datë 5.3.1999, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si vijon:
"Kredia jepet me vlerë 5 milionë lekë me interes 3 për qind dhe afat kthimi deri në 25 vjet, për

funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, dhe 2.5 milionë lekë me interes 3 për qind dhe afat kthimi deri në 15 vjet, në përputhje me kërkesën e paraqitur nga funksionari.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.708, datë 21.12.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.206, DATË 26.3.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E PJESËMARRJES SË SHTETIT NË PËRBALLIMIN E DËMEVE, NË RASTE FATKEQËSISH”

Në mbështetje të neneve 100 dhe 108 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e ministrit të Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.206, datë 26.3.1998, të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafet e parë dhe të dhjetë të pikës 3, fjalët “këshilli i rrethit”, zëvendësohen me “këshilli i qarkut”.

2. Në pikën 8.4 dhe në pikën 9, fjala “rreth” zëvendësohet me fjalën “qark”.

3. Në paragrafin e katërt të pikës 3, në paragrafin e parë të pikës 6 dhe në pikat 8.4 dhe 9, fjalët “Sekretariat shtetëtor për pushtetin lokal” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Pushtetit Lokal”.

4. Në paragrafin e parë të pikës 6 dhe në pikën 9, pas fjalëve “Ministria e Punëve Publike…” hiqen fjalët “… dhe Transporteve”.

5. Në paragrafin e pestë të pikës 6.b, pas fjalëve “…brenda zonës së zhvillimit me plan rregullues…” hiqen fjalët “…të miratuar nga KRRT-ja e rrethit” dhe shtohen fjalët “…nga organet përgjegjëse”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.718, datë 21.12.2000

PËR SHPALLJEN PASURI KULTURORE TË DISA KALAVE DHE KËSHTJELLAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2,16 dhe 17 të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Shpallen pasuri kulturore:
1. Kalaja e Shkodrës
2. Kalaja e Lezhës
3. Kalaja e Krujës
4. Kalaja e Durrësit
5. Kalaja e Beratit
6. Kështjella e Gjirokastrës
7. Kështjella e Porto-Palermos
8. Kalaja e Himarës

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, me Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe me njësitë e qeverisjeve vendore në territoret e të cilave ndodhen objektet e përcaktuara në pikën 1, të bëjë, brenda 30 ditëve, përcaktimin e kufijve të zonave të mbrojtura.

3. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve buxhetorë, të miratuar, të miratojë strukturat e administrimit të këtyre objekteve.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe bashkitë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.725, datë 23.12.2000

PËR REGJIMIN E TRANZITIMIT TË DUHANEVE DHE CIGAREVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Duhanet dhe cigaret (sipas kapitullit 24 të nomenklaturës së kombinuar), lejohen të tranzitohen nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, pa pulla fiskale të Ministrisë së Financave, të Republikës së Shqipërisë, kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni në fuqi, vetëm për qëllime të tranzitimit, kur ky tranzitim fillon dhe mbaron jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Tranziti, sipas pikës 1 të këtij vendimi, kryhet sipas lejes së dhënë nga ministri i Financave, për personat që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

janë persona juridikë, me seli në Republikën e Shqipërisë dhe janë regjistruar sipas legjislacionit shqiptar;

janë të pajisur me kodin fiskal dhe NIPT-in e regjistrimit në organet tatimore;

kanë besueshmëri dhe nuk kanë kryer asnjë shkelje të ligjeve doganore dhe fiskale;

paraqesin të dhëna për vëllimin e tranziteve që parshikojnë të kryejnë për një periudhë njëvjeçare;

paraqesin dokumentacion që të vërtetojnë se ndaj tyre nuk kanë filluar procedura falimentimi ose likuidimi.

3. Çdo tranzit i mallrave të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, të shoqërohet nga organet doganore dhe të garantohet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Doganor.

Për çdo tranzit, paguhet një tarifë shërbimi në masën 10 USD për koli, për cigaret dhe 500 USD për ton, për duhanet. Kjo tarifë paguhet nga subjekti dhe arkëtohet nga zyra doganore në çastin e depozitimit dhe të regjistrimit të deklaratës doganore (DAP) për tranzit.

4. Leja për tranzitimin e mallrave të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, revokohet nga ministri i Financave, sipas propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, kur shkelen dispozitat e legjislacionit, doganor dhe fiskal, ose kur njëra nga kërkesat që subjekti ka marrë lejen, pushon së ekzistuari.

5. Leja për përdorimin e këtij regjimi jepet për një periudhë kohe njëvjeçare, me të drejtë ripërsëritjeje.

6. Rregullave për furnizimin me mallrat e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, dhe të tarifave të shërbimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, i nënshtrohen edhe furnizimit me destinacion magazinat doganore, të tipit "C" (magazina furnizimi dhe Duty Free Shops).

7. Vendimi nr.254, datë 21.9.1991, i Këshillit të Ministrave, "Për ndalimin e veprimtarisë së tranzitimit të cigareve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.727, datë 28.12.2000

PËR CAKTIMIN E KUFIRIT MINIMAL TË REGJISTRIMIT PËR TVSH-NË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është 8 milion lekë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.728, datë 28.12.2000

PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE DETYRAT E KOMISIONEVE TË REGJISTRIMIT TË

POPULLSISË DHE TË BANESAVE NË QARQE (PREFEKTURA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000, "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave", me propozimin e zëvendësministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Ngritjen e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qarqe (prefektura).

1. Për organizimin dhe realizimin e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, brenda territorit të qarkut (prefekturës), krijohet komisioni i regjistrimit të popullsisë dhe të banesave.

II. Përbërja e zyrave të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë).

1. Përbërja e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë), të jetë si vijon:

- Prefekti — kryetar
- Kryetari i këshillit të qarkut — nënkryetar
- Kontrollorë — anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të statistikës në qark — anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të bujqësisë në qark — anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të arsimit në qark — anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të shëndetësisë në qark — anëtarë
- Drejtorët e drejtorive të buxhetit në qark — anëtarë
- Mbikëqyrësit e drejtorive të statistikës në qark — anëtarë
- Përgjegjësit e zyrave të gjendjes civile në qark — anëtarë
- Drejtori i drejtorisë së policisë në qark — anëtar

III. Detyrat e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë).

1. Në zbatim të udhëzimeve dhe të përcaktimeve të Institutit të Statistikave komisioni i regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në qark (prefekturë), ka këto detyra:

organizon punën përgatitore për regjistrimin e popullsisë dhe të banesave, brenda territorit të qarkut (prefekturës);

përzgjedh personelin e regjistrimit;

trajnon kontrollorët dhe merr masat e nevojshme për zbatimin, në kohë dhe me korrektësi, të procesit të regjistrimit;

jep asistencë teknike për zyrat e regjistrimit në bashki dhe komuna, të cilat janë brenda territorit të prefekturës, dhe bën inspektime periodike në këto zyra, për zhvillimin e procesit të regjistrimit;

raporton, një herë në javë, pranë Institutit të Statistikave për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit në qark (prefekturë) dhe çdo ditë gjatë muajit të regjistrimit;

në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me zyrat e regjistirmit në bashki dhe komunë, organizon punën për marrjen dhe dërgimin e pyetësorëve të regjistrimit dhe të materialeve shoqëruese në komisionet dhe në zyrat e regjistrimit, në bashki dhe komuna.

IV. Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qark (prefekturë).

1. Komisionet e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në qarqe (prefektura) ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri më 31.1.2001.

V. Detyrimet metodologjike

1. Komisionet e regjistrimit në qarqe (prefektura), për ndjekjen dhe zbatimin e veprimeve të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave, udhëzohen nga Instituti i Statistikave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.734, datë 28.12.2000

PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE DETYRAT E ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË POPULLSISË DHE TË BANESAVE NË BASHKI E KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000, "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave", me propozimin e zëvendësministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Ngritjen e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki e komuna.

1. Për organizimin dhe realizimin e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, brenda territorit të bashkisë e komunave, ngrihen zyrat e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në këto bashki e komuna.

II. Përbërja e zyrave të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki dhe komuna.

1. Përbërja e zyrave të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki të jetë si vijon:

- Kryetari i bashkisë	kryetar
- Përgjegjësi i zyrës së gendjes civile	anëtar
- Kontrollori	anëtar

Numri i kontrollorëve të zyrës së regjistrimit në bashki të jetë në varësi të numrit të popullsisë dhe të zonave të anketimit. Çdo kontrollor është përgjegjës për disa anketues, që kanë përgjegjësinë e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave për 80 deri në 100 familje.

2. Përbërja e zyrës së regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në komuna të jetë si vijon:

- Kryetari i komunës	kryetar
- Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile	anëtar
- Kontrollor	antëar

Numri i kontrollorëve të zyrës së regjistrimit në komuna të jetë në varësi të numrit të popullsisë dhe të zonave të anketimit.

III. Detyrat e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki e komuna

1. Në zbatim të udhëzimeve dhe të përcaktimeve të Institutit të Statistikave, komisioni i regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki e komuna, ka këto detyra:

merr masat e nevojshme për të siguruar zhvillimin normal të regjistrimit brenda territorit të bashkisë dhe komunës;

jep të dhëna dhe asistencë për personelin e regjistrimit, në qytete dhe në fshatra;

përzgjedh dhe trajnon anketuesit dhe kontrollon kryerjen e detyrave të tyre;

raporton, një herë në javë pranë komisionit të regjistrimit në prefekturë, dhe pranë drejtorisë rajonale të statistikës për zhvillimin e procesit të regjistrimit, brenda territorit të bashkisë ose komunës. Gjatë periudhës së regjistrimit në terren raporton çdo ditë;

merr masa për sigurimin e pranimit, në gjendje të mirë, të materialeve të regjistrimit në bashki ose komunë, depozitimin e sigurt të këtyre materialeve, vënien në dispozicion të kontrollorëve dhe anketuesve dhe kthimin e dorëzimin në kohë të materialeve, pranë komisionit të regjistrimit në prefekturë.

IV. Detyrat e personelit që kryen regjistrimin në terren.

1. Detyrat, kriteret dhe përshkrimi i vendit të punës për kryembikëqyrësit e prefekturave, për mbikëqyrësit e drejtorive rajonale të statistikës dhe për kontrollorët dhe anketuesit përcaktohen nga Instituti i Statistikave.

V. Kohëzgjatja e funksionimit të komisioneve

1. Zyrat e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki e komuna, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri më 31.7.2001.

VI. Detyrimet metodologjike.

1. Zyrat e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki e komuna, udhëzohen për ndjekjen dhe zbatimin e veprimeve për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë e të banesave nga Instituti i Statistikave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.737, datë 28.12.2000

PËR PËRCAKTIMIN E TERMAVE DHE TË KUSHTEVE TË BONOVE TË THESARIT, PËR DETYRIMIN E SHTETIT DHE PËR RIKAPITALIZIMIN E BANKËS SË KURSIMEVE, SH.A.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 3 të ligjit nr.8726, datë 26.12.2000, "Për mbulimin me bono thesari të detyrimeve të shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve dhe rikapitalizimin e saj me bono thesari", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Detyrimi i shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve, sh.a, për shumat 7 607 milionë lekë dhe 9 640 milionë lekë të bëhet nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit, sipas termave, kushteve dhe karakteristikave të mëposhtme:

a) Emetuesi: - Ministria e Financave

b) Lloji i letrave me vlerë: - Bono thesari

c) Forma e emetimit: - Me vlerë të skontuar në një regjistër të veçantë, pranë Bankës së Shqipërisë

ç) Data e emetimit: - 29 dhjetor 2000.

d) Shuma e emetimit - 17 247 milionë lekë, me prerje të tregtueshme 100 milionë lekë

dh) Afati i maturimit - 6 muaj, me të drejtë rinovimi.

e) Norma e interesit - e barabartë me nivelin mesatar të YILD-it të bonove të thesarit, me afat maturimi 6-mujor, të ankandeve më të afërta, para dhe pas datës 29 dhjetor 2000, për periudhën e investimit. Pas kësaj periudhe bonot e thesarit do të riinvestohen gradualisht në ankandet e radhës.

f) Tregtueshmëria - Bonot mund të shiten apo të skontohen nga mbajtësi, sipas zhvillimit të gjendjes monetare dhe pozicioneve të likuiditeteve të sistemit bankar, në përgjithësi, dhe të bankave, në veçanti, por jo më përpara se data dy muaj pas datës së emetimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Agron Lamaj	Anëtar
Artan Hoxha	“
Bashkim Caka	“
Metush Saraçi	“
Natasha Sheshi	“
Ylvi Myrtja	“
Vladimir Bineri	“
Valentina Kondili	“
Vangjel Kosta	“
Zamir Poda	“
Nikoleta Kita	“
Vladimir Metani	“

në seancën gjyqësore të datës 08.12.1999 morën në shqyrtim çështjen penale nr. 81 që i përket:

KËRKUESIT: ARBEN HAMITI

OBJEKTI: Shuarje e dënimit për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike dhe kalimit të paligjshëm të kufirit, parashikuar nga nenet 283/1 dhe 297 të Kodit Penal.

Baza Ligjore: Neni 480 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në zbatim të ligjit Nr. 8202, datë 27.03.1997 “Për amnistinë”, me vendimin nr.1, datë 19.05.1999 ka pranuar kërkesën e të dënuarit Arben Hamiti për shuarjen e dënimit, dhe ka urdhëruar lirimin e tij të menjëhershëm.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka bërë rekurs prokurori i cili parashtron si shkaqe për prishjen e tij si më poshtë:

1. Kërkuesi është dënuar me një vendim të një gjykate të huaj, dhe Gjykata e shkallës së parë Delvinë ka bërë vetëm njohjen e vendimit dhe konvertimin e dënimit sipas ligjit shqiptar.
2. Ligji “Për amnistinë” ka hyrë në fuqi në datën 05.04.1997 dhe ka patur fuqi vetëm për vepra penale të kryera në Shqipëri.
3. Njohja e vendimit është bërë në muajin Qershor 1998, në një kohë që ligji “Për amnistinë” kishte përfunduar efektet e tij.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan realacionin e anëtarit Vladimir Metani, prokuroren Valentina Ahmetaj, e cila kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, si të pabazuar në ligj dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit e për

këtë shkak ai duhet të prishet.

Nga materialet e ndodhura në dosje rezulton se kërkuesi Arben Hamiti me vendimin Nr. 90, datë 16.10.1996 të Gjykatës së Diktimit Janinë të Greqisë, është dënuar me 18 vjet dhe 6 muaj burgim, me gjobë 5 milion dhrahmi, privimin e të drejtave politike për 3 vjet dhe dëbim të përjetshëm nga shteti grek, pas vuajtjes së dënimit për veprat penale të:

a. "Zotërimit të lëndëve narkotike"

b. "Transportit të lëndëve narkotike"

c. "Importit të lëndëve narkotike"

d. "Shitjes së lëndëve narkotike e mbetur në tentativë"

e. "Hyrjes së paligjshme në vend".

Kërkuesi, bazuar në Konventën e Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar", ratifikuar me Ligjin Nr. 8499, datë 10.6.1999 dhe në Konventën dypalëshe të datës 17.5.1997 lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Greqisë, ka kërkuar të transferohet në Shqipëri për të vuajtur dënimin e caktuar nga autoritetet gjyqësore greke.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Delvinë, në zbatim të nenit 512 të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e saj, Nr. 9, Akti datë 23.05.1998 ka bërë njohjen e pjesshme të vendimit Nr. 90 datë 16.10.1996 të Gjykatës së Diktimit Janinë, si dhe ka caktuar përfundimisht dënimin prej 13 vjet burgim, që i dënuari Arben Hamiti duhet të vazhdojë të vuajë në shtetin shqiptar.

Kërkuesi Arben Hamiti ka qenë duke vuajtur dënimin e mësipërm në burgun e Bënçës në Tepelenë dhe në datën 22.4.1999 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që të vendosë shuarjen e dënimit të mbetur në zbatim të nenit 480/II të Kodit të Procedurës Penale dhe paragrafit të parë të nenit 1 të ligjit Nr. 8202 datë 27.03.1997, "Për amnistinë" për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/1 dhe 297 të Kodit Penal, për të cilat ai vuan dënimin.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin Nr. 1, datë 19.5.1999 ka pranuar kërkesën e të dënuarit Arben Hamiti dhe ka urdhëruar lirimin e tij nga vendi i vuajtjes së dënimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të rekursit të ushtruar nga prokurori kundër vendimit të mësipërm, duke qenë në dijeni të zgjidhjeve e qëndrimeve të ndryshme mbajtur nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe të apelit për çështje të tjera të të njëjtit karakter, me qëllim njehsimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore, vendosi kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të kësaj Gjykate.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke e gjetur të pabazuar në ligj Vendimin Nr. 1, datë 19.5.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, vendosën unifikimin e praktikës gjyqësore, lidhur me shtrirjen e ligjit penal shqiptar në kohë dhe hapësirë për shtetasit shqiptarë që kryejnë vepra penale jashtë territorit të Republikës për të cilat deklarohen fajtorë me një vendim të formës së prerë të autoritetit gjyqësor të shtetit të huaj.

Për të arritur në përfundimet e veta, Kolegjet e Bashkuara, marrin në konsideratë dhe zbatojnë dispozitat dhe frymën e konventave të Këshillit të Europës në fushën përkatëse në të cilat Shqipëria është palë, konventën dy palëshe me shtetin grek për trasferimin e të dënuarve të burgosur, dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale si dhe Ligjin Nr. 8202 datë 27.03.1997 "Për amnistinë".

Ndonëse nuk është objekt i këtij gjykimi, Kolegjet e Bashkuara vënë në dukje se gjykata me rastin e njohjes së vendimit të gjykatës greke, me të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar Arben Hamiti, duhej të merrte në konsideratë dhe të shprehej në vendimin e saj edhe përsa i përket faktit nëse do të shtrinte ose jo efektet e tij Ligji Nr. 8202, datë 270.301997 "Për amnistinë".

Sipas nenit 514 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 2 të Konventës Europiane "Për transferimin e personave të dënuar", një nga kushtet për transferimin është dënueshmeria e veprës si në shtetin që kërkohet transferimi, ashtu edhe në shtetin ku zbatohet vendimi. Mbi këtë bazë, gjykata ka patur detyrim ligjor për të arritur në përfundime të shprehura me vendimin e saj dhe, duke mbajtur një qëndrim të qartë do të garantonte edhe marrëdhëniet juridiksionale me shtetin grek.

Sipas dy konventave kryesore të Këshillit të Europës në këtë fushë, asaj për vlerën ndërkombëtare të gjykimeve penale e vitit 1970 dhe për transferimin e të dënuarve me heqje lirie të vitit 1983, aplikimi i

bashkëpunimit në drejtim të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve penale, realizohet nëpërmjet zgjerimit dhe ngushtimit në të njëjtën kohë të juridiksioneve të autoriteteve gjyqësore të vendeve që përfshihen në një veprimtari të tillë. Qëllimi që ndjekin konventat, përkrahur edhe nga legjislacionet e shteteve palë në to, është ekzekutimi i një vendimi gjyqësor i huaj dhe rehabilitimi i shpejtë i personit të dënuar në vendin e tij të origjinës.

Ky lloj bashkëpunimi si për të gjithë shtetet palë në këto konventa edhe për Shqipërinë, realizohet në dy drejtime:

1) Për shtetasin shqiptar që ka kryer një vepër penale në një shtet tjetër, por që ndodhet në Shqipëri, ndërkohë që për të ka një një vendim të formës së prerë dënimi nga autoriteti gjyqësor i shtetit ku ka kryer veprën penale. Në këtë rast, duke qenë shtetas shqiptar dhe në pamundësi për t'u ekstraduar, gjykata shqiptare sipas procedurave që parashikon Kodi i Procedurës Penale, njeh dhe ekzekuton vendimin e gjykatës së huaj.

2) Për shtetasin shqiptar, që është duke vuajtur një dënim me heqje lirie të dhënë e të vënë në ekzekutim në një vend tjetër, për të cilin kërkohet transferimi i tij në Shqipëri për vazhdimin e ekzekutimit të vendimit të autoritetit gjyqësor të huaj në Shqipëri.

Sikurse shihet, në të dy rastet kemi të bëjmë me një vendim të autoritetit gjyqësor të shtetit të dënimit, i cili njihet dhe vihet në ekzekutim në shtetin e ekzekutimit në përputhje me procedurat e pranuara nga konventat përkatëse dhe Kodit të Procedurës Penale.

Për efekt të njehsimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara pranojnë se për të gjykuarin Arben Hamiti, si për çdo rast tjetër, vendimi i gjykatës shqiptare nuk është një vendim i ri. Për këtë shkak, gjykata nuk shqyrton çështjen në themel, dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e huaj. Ajo verifikon nëse ekzistojnë kushtet për njohjen e vendimit të huaj dhe, a duhet t'i përgjigjet atij vendimi me një dënim që konverton dënimin e huaj me një dënim të parashikuar nga legjislacioni shqiptar, duke përcaktuar edhe dispozitat përkatëse të cilat aplikohen. E rëndësishme, sipas Kolegjeve të Bashkuara, është të evidentohet fakti se është vendimi i huaj ai që vihet në ekzekutim nëpërmjet një vendimi njohës të gjykatës Shqiptare. Pra nuk kemi të bëjmë me një vendim të gjykatës shqiptare që vihet në ekzekutim, por me një vendim të një gjykate të huaj që ekzekutohet në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kolegjet e Bashkuara pranojnë faktin se transferimi i personave të dënuar nga një shtet i huaj, është një zgjerim i juridiksionit të autoritetit gjyqësor të huaj në Shqipëri, i cili përfundon pas njohjes dhe ekzekutimit të tij në Shqipëri.

Në kuptim të Konventës Europiane "Për transferimin e personave të dënuar", është e rëndësishme të evidentohet për sa më sipër se vendimi i autoritetit të huaj mund të ekzekutohet në dy mënyra në shtetin e zbatimit:

a) nëpërmjet vazhdimit të ekzekutimit automatikisht të vendimit të dhënë nga autoriteti i huaj ose

b) nëpërmjet një procedure konvertimi të këtij dënimi, duke zëvendësuar sanksionet e dhëna nga shteti i huaj me sanksione të parashikuara nga shteti i zbatimit.

Megjithatë, pavarësisht nga mënyra e ekzekutimit, në çdo rast bëhet fjalë për ekzekutimin e vendimit të dhënë nga shteti i dënimit në atë të kërkuar dhe jo për një vendim të ri dënimi, qoftë edhe kur ai njihet nëpërmjet konvertimit. Ky fakt ka rëndësi të sqarohet për të evituar keqkuptimet që mund të krijojë neni 2 i Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar", ku Shqipëria pranon zbatimin e vendimeve të huaja jo nëpërmjet zbatimit të drejtpërdrejtë të tyre, por nëpërmjet konvertimit të dënimit të huaj në një dënim të bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Edhe në këtë rast, shteti shqiptar duke pranuar frymën e konventës, ka pranuar vetëm njërën nga mënyrat e ekzekutimit, pa ndryshuar asgjë nga përmbajtja e konventës.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në shqyrtim të çështjes, përveç dispozitave të Konventës së Këshillit të Europës dhe Konventës Bilaterale me Greqinë, Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit Nr. 8202 datë 27.03.1997, "Për amnistinë", merr në konsideratë edhe dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë përsa i përket zbatimit të dispozitave të tij në kohë dhe hapësirë.

Neni 6 i Kodit Penal, në paragrafin e dytë përcakton se: "Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është

njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj". Pra, dispozita përcakton dy kushte për zbatimin në hapësirë të ligjit penal. Së pari, fakti duhet të konsiderohet vepër penale nga legjislacioni i vendit ku është kryer, si dhe nga ai shqiptar; së dyti, për këtë vepër duhet të mos jetë dhënë vendim i formës së prerë nga autoriteti gjyqësor i huaj.

Kolegjet e Bashkuara duke konsideruar këto kushte të lidhura e jo të shkëputura nga njëra-tjetra, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, arrijnë në përfundimin se ligji penal shqiptar nuk shtrin efektet e tij ndaj shtetasve shqiptarë që kryejnë vepër penale në territorin e një shteti tjetër, kur për këtë vepër autoriteti gjyqësor i shtetit të huaj ka dhënë një vendim i cili ka marrë formë të prerë. Edhe në rastin konkret kur çështja penale ka filluar, ajo duhet të pushohet duke zbatuar nenin 328/1, germa "e" dhe "f" të Kodit të Procedurës Penale, pasi për të njëjtën vepër penale ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë. Kjo garanci procedurale e parashikuar edhe në nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale, është shprehja dhe zbërthimi i garancisë kushtetuese të njohur në nenin 34 të saj, që duke përkrahur parimin e së Drejtës Romake "Non bis in idem", përcakton se: "Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjeve nga një gjykatë më e lartë sipas mënyrës së parashikuar në ligj".

Duke mbajtur qëndrimin e mësipërm, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin që Ligji Nr. 8202, datë 27.03.1997 "Për amnistinë", nuk shtrin efektet e tij për shtetasit shqiptarë që kanë kryer vepra penale jashtë territorit shqiptar, të cilët janë dënuar me një vendim përfundimtar nga autoriteti gjyqësor i huaj në kohën e hyrjes në fuqi, as drejtpërdrejtë, dhe as pas transferimit të tyre në Shqipëri.

Sipas këtij ligji, përjashtohen nga ndjekja penale dhe vuajtja e mëtejshme e dënimit të gjithë personat që kanë kryer veprat penale për të cilat ai ligj shprehet. Me ligjin Nr. 8268, datë 22.12.1997 është amenduar shtrirja në kohë e ligjit të mësipërm deri më datën 30.1.1998 për ata persona, të cilët paraqiteshin vullnetarisht përpara autoriteteve kompetente.

Kolegjet pranojnë se ky ligj doli në një situatë të caktuar që u krijua në Shqipëri në vitin 1997, atëherë kur strukturat shtetërore morën një goditje të rëndë. Burgjet Shqiptare u hapën fillimisht me forcë, dhe më vonë, për arsye sigurie, shteti liroi të gjithë personat që mbaheshin të paraburgosur ose të burgosur në vuajtje të një dënimi të formës së prerë.

Meqënëse kjo situatë duhej të normalizohej me kalimin e periudhës së emergjencës, një nga masat e marra për këtë qëllim ishte edhe miratimi i ligjit "Për amnistinë", i datës 27.03.1997 i cili kishte në themel amnistimin e personave që kishin kryer një kategori të caktuar veprash penale dhe për personat e tjerë, me kushtin e kthimit vullnetarisht në vendet e vuajtjes së dënimit. Në këto raste parashikohej ulja e dënimit me burgim në 1/3 e tij dhe moszbatimi i dënimit me burgim të përjetshëm.

Sqarimi i këtyre shkaqeve dhe rrethanave të daljes së ligjit "Për amnistinë", kanë rëndësi të evidentohen për të kuptuar me të drejtë faktin e shtrirjes së efekteve në territorin shqiptar, për vepra të kryera në këtë territor nga individë shqiptarë ose të huaj, për një situatë dhe periudhë të caktuar kohe.

Sipas arsyetimit të mësipërm, Kolegjet çmojnë se ligji "Për amnistinë" i vitit 1997 nuk i shtrin efektet e tij ndaj kërkuesit, si gjatë kohës kur ndodhej në tërritorin e shtetit grek, ashtu edhe pas transferimit, me qëllim ekzekutimin e vendimit të atij autoriteti për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit të huaj në Shqipëri.

Nga ana tjetër, është e vërtetë se neni 12 i Konventës së Këshillit të Europës, si dhe neni 12 i Konventës bilaterale me Greqinë parashikojnë që palët të japin falje, amnisti ose zëvendësim të dënimit në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionet e tyre për të dënuarit e transferuar, por duhet marrë parasysh situata pas lejimit dhe ekzekutimit të transferimit; apo në rastet kur amnistia ose falja shprehet edhe për subjekte që ndodhen jashtë territorit të vendit.

Një rëndësi të veçantë ka ushtrimi i sovranitetit dhe zbatueshmëria e Kushtetutës dhe ligjeve nga ana e autoriteteve shtetërore brenda territorit të secilit shtet palë në Konventë. Njëkohësisht, është e rëndësishme edhe garantimi i standarteve të njëjta për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që ndiqen penalisht apo që janë në ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në këtë kuadër edhe kërkuesi mund të përfitojë nga këto dispozita të Konventave dhe neni 480/II i Kodit të Procedurës Penale, që nga koha që është transferuar në territorin shqiptar, por jo të përfitojë për kohën përpara

transferimit, për të cilën në rastin konkret nuk mund të aplikohet zbatimi i ligjit shqiptar për shkak të shtrirjes së kufizuar të tij në hapësirë.

Duke qenë se ligji Nr. 8202, datë 27.03.1997 "Për amnistinë", nuk i shtrin efektet për personat e transferuar, për të vuajtur dënimin e dhënë nga autoriteti gjyqësor i huaj në shtetin Shqiptar, kërkesa e të dënuarit Arben Hamiti nuk duhej të pranohej, dhe për këtë shkak, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i cënueshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 438,441/c dhe 442 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N:

1. Prishjen e vendimit nr. 1 datë 19.05.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe rrëzimin e kërkesës nga ana e të dënuarit Arben Hamit.

2. Njoftimin për ekzekutim të këtij vendimi Prokurorit pranë Gjykatës së Lartë për rivënien në ekzekutim të vendimit nr. 9, aktit datë 23.05.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Delvinë, i cili ka njohur dhe ka vënë në ekzekutim Vendimin Nr. 90, datë 16.10.1996 të Gjykatës së Diktimit Janinë.

3. Vendimin për njehsimin e praktikës gjyqësore dhe dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 27.10.2000

MENDIM PAKICE

Lidhur me shqyrtimin e çështjes në fjalë në Kolegjet e Bashkuara dhe vendimin e marrë nga shumica, kemi mendim të kundërt përsa më poshtë:

1. Rekursi i prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nuk duhej të merrej në shqyrtim nga Kolegjet e Bashkuara, pasi ai nuk është paraqitur sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Sarandë, prokurori ka bërë rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë, pa bërë më parë ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, brenda afateve që parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Ky detyrim për paraqitjen e ankimit vetëm në gjykatën e apelit, del nga përmbajtja e nenit 407, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohen mjetet e ankimit dhe radha e paraqitjes së tyre në organet gjyqësore kompetente.

Për të njëjtën gjë flet dhe neni 417, i Kodit të Procedurës Penale, i cili në përmbajtjen e tij, nënkupton se ankimi kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit, bëhet vetëm në Gjykatën e apelit.

Përveç sa u paraqit si argument, se ankimi duhej të ishte paraqitur në Gjykatën e Apelit dhe jo në Gjykatën e Lartë, shërben dhe fakti se palëve në proces, pra dhe prokurorit, Kodi i Procedurës Penale i njeh të drejtën për t'u drejtuar, drejtpërsëdrejti, Gjykatës së Lartë me rekurs vetëm për raste të veçanta të cilat parashikohen në nenin 431, të këtij kodi, si dhe në raste të tjera kur kjo e drejtë është e parashikuar në ligj.

Duke qenë se rasti në shqyrtim nuk është nga ato që parashikon neni 431, i Kodit të Procedurës Penale, si dhe duke patur parasysh se për rastin në fjalë nuk ka rregullim të veçantë të parashikuar në ndonjë ligj, kemi mendimin se rekursi i prokurorit të rrethit Sarandë, në bazë të nenit 433, të Kodit të Procedurës Penale, duhej të mos pranohej.

2. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka vendosur pranimin e kërkesës të të dënuarit për përjashtimin nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, është i drejtë dhe i bazuar në ligje.

Transferimi i të dënuarit në falje, ashtu sikurse pranon dhe shumica, është realizuar në përputhje

me legjislacionin shqiptar dhe marrëveshjen midis qeverisë shqiptare dhe asaj greke.

Legjislacioni shqiptar, si në drejtim të të drejtave, ashtu edhe në drejtim të detyrimeve, shtetasin shqiptar, të dënuarin nga gjykata e huaj e të transferuar në Shqipëri, e trajton njëlloj, pa asnjë diferencim nga të dënuarit prej gjykatave shqiptare.

I gjithë legjislacioni shqiptar, i dalë përpara transferimit të të dënuarit, si dhe pas transferimit të tij, nuk parashikon asnjë kufizim në trajtimin e të dënuarve, të cilët vuajnë dënimin në Shqipëri.

Në këtë kuptim, dhe ligji shqiptar "Për amnistinë" në kushtet kur plotësohen kriteret e përcaktuara prej tij, nuk përjashton nga e drejta për të përfituar nga mosvuajtja e mëtejshme e dënimit të dënuarin nga gjykata e huaj, të transferuar në Shqipëri.

Duke patur parasysh për sa u paraqit, jemi të një mendimi me shumicën, për faktin se i gjithë legjislacioni shqiptar, edhe ligji "Për amnistinë" i shtrin efektet e tij vetëm në territorin e Shqipërisë. Në këtë kuptim, ligji "Për amnistinë", duke mos përmendur asnjë kufizim, i shtrin efektet e tij mbi çdo të dënuar që vuan dënimin në Shqipëri, pra edhe mbi të dënuarin e transferuar nga një shtet juaj.

Arsyetimi i shumicës, sipas së cilës ndaj të dënuarit të transferuar, ligji "Për amnistinë", nuk mund të zbatohet, në kohën e daljes së tij i dënuari ka qenë duke vuajtur dënimin në shtetin tjetër, si dhe arsyetimi tjetër; se përfitimi nga ky ligj për të dënuarin që është në Shqipëri bëhet në afate të caktuara.

Është e vërtetë se në shtetin dënues, i dënuari, shtetas shqiptar, nuk mund të përfitojë nga ligji "Për amnistinë" për faktin se ligji penal shqiptar i shtrin efektet e tij vetëm në teritorin e Republikës së Shqipërisë (neni 5 i Kodit Penal).

Megjithatë, meqë ndodhet në shtetin ekzistues, pra në Shqipëri, i dënuari, i transferuar për të vuajtur dënimin e mëtejshëm, nuk mund të kufizohet nga e drejta që i jep ky ligj ashtu si të gjithë të dënuarit e tjerë, pavarësisht se ligji "Për amnistinë" ka dalë kohë më parë.

Siç dihet, ligji "Për amnistinë është ligj penal". Në këtë kuptim detyrimi që sjell neni 29, pika 3 e Kushtetutës, sipas të cilit ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese, për rastin në shqyrtim, është i detyrueshëm për t'u zbatuar. Si Kushtetuta, ashtu dhe vetë ligji Nr. 8268, datë 22.12.1997, nuk ka të bëjë me të dënuarit që përfitojnë nga amnistia, por me personat që kanë kryer vepra penale, të cilët sipas ligjit "Për amnistinë", nuk janë amnistuar përsa i përket ndjekjes apo dënimit penal.

Si argument tjetër, se ligji "Për Amnistinë" zbatohet edhe për të dënuarin e transferuar nga një shtet i huaj, flet dhe KONVENTA MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË GREQISË PËR TRANSFERIMIN E TË DËNUARVE TË BURGOSUR, në nenin 7 të saj.

Neni 7, germa "a", e kësaj konvente, shprehet se: "Transferimi mund të refuzohet kur autoritetet kompetente të shtetit ekzistues kanë vendosur të mos fillojnë ndjekjen penale ose t'iu japin fund atyre, për të njëjtat fakte".

Siç del nga përmbajtja e kësaj dispozite, të dy palët, nënshkruese të konventës kanë pranuar faktin se, në shtetin ekzistues (Shqipëri), përpara realizimit të transferimit të një të dënuari, mund të ekzistojnë kushte të vendosura nga organet kompetente (Kuvendi), të cilat e përjashtojnë atë nga ndjekja penale ose nga vuajtja e mëtejshme e dënimit, kur bëhet fjalë për të njëjtat fakte (të njëjtat ngjarje),të cilësuara nga të dy shtetet përkatëse si vepra penale.

Duke interpretuar rastin në shqyrtim, del se të dy shtetet, palët në marrëveshje, kanë pranuar se në Shqipëri, përpara realizimit të transferimit të të dënuarit, mund të ndodhen dhe përpara faktit të një amnistie të dhënë. Në këto kushte, duke njohur të drejtën e zbatimit të ligjit shqiptar në territorin e Shqipërisë, pra dhe të drejtën e të dënuarit, për të përfituar nga amnistia, shteti grek ka rezervuar të drejtën për të vendosur për miratimin ose jo të transferimit të kërkuar.

Për rastin në shqyrtim, shteti grek, megjithëse e ka patur parasysh ekzistencën e ligjit "Për amnistinë" dhe të drejtën e të dënuarit për të përfituar nga ky ligj, ka miratuar dhe lejuar transferimin e tij në Shqipëri.

Në kushtet e mungesës së ndonjë pengese ligjore, moszbatimi për të dënuarin në fjalë i ligjit "Për amnistinë", sjell kufizime të të drejtave të tij kushtetuese, duke e vënë atë në pozitë të pabarabartë përpara ligjit dhe të dënuarve të tjerë pra të diskriminuar, duke shkelur kështu nenet 18, pika 1, 16, 17, pika 1, etj. të Kushtetutës së Shqipërisë.

ANËTAR	ANËTAR	ANËTAR
V. BINERI	Y. MYRTJA	B. CAKA

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese	
Sabri Rrapi,	Anëtar	“ “
Zija Vuci,	Anëtar	“ “
Hajredin Fuga,	Anëtar	“ “
Alfred Karamuço,	Anëtar	“ “
Kujtim Puto,	Anëtar	“ “
Sokol Sadushi,	Anëtar	“ “
Kristofor Peçi,	Anëtar	“ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datat 3.10.2000 dhe 13.11.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41 akti që i përket:

KËRKUESE:PAVLINA NIKAJ, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore

SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË BASHKISË KORÇË, në mungesë.
2. LLAZI KRESHPANJI, në mungesë.

O B J E K T I

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.12, datë 15.12.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.773, datë 2.6.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.P-1, datë 9.2.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesja parashtron këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve:

1. Është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik sipas nenit 42 të Kushtetutës, pasi në kolegjin civil dhe kolegjin seleksionues nuk kanë marrë pjesë palët dhe nuk është shqyrtuar bazueshmëria e vendimit të gjykatës së apelit në ligj e në prova.

2. Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka zhvilluar proces të rregullt, pasi nuk ka bërë hetim gjyqësor dhe nuk u ka dhënë mundësi palëve të realizojnë të drejtat e tyre, në një kohë që çështja gjykohej në shkallë të parë, pas prishjes së vendimit nga kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit. Për më tepër, nuk janë zbatuar as detyrat e lëna nga ky kolegj, megjithëse në bazë të nenit 493 të Kodit të Procedurës Civile, kanë qenë të detyrueshme për t’u zbatuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi pretendimet dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka shqyrtuar çështjen pas prishjes së vendimit nga kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.12, datë 15.12.1996 ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueses Pavlina Nikaj, me objekt anullimin e vendimit nr.965, datë 25.7.1995 të Komisionit të Kthimit dhe

Kompensimit të Pronave Korçë. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit dhe Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë me vendimet nr.773, datë 2.6.1997 dhe nr.P-1, datë 9.2.2000, kanë vendosur në Dhomën e Këshillimit mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Penale.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, duke i konsideruar alogjikë dhe në kundërshtim me ligjin vendimet e Gjykatës së Rrethit Korçë dhe asaj të apelit Tiranë, i ka prishur ato dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit, por me tjetër trup gjykues. Në vendimin e kolegjit civil, arsyetohet se të dy gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt provat e administruara, se pa të drejtë është vlerësuar si provë vendimtare në favor të palës së paditur vendimi civil nr.1830, datë 14.9.1994 i Gjykatës së rrethit Korçë dhe mohohet vendimi tjetër civil i po kësaj gjykate me nr.529, datë 3.5.1993 që bën fjalë për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë për objektin që është në shqyrtim gjyqësor. Të dy këto vendime, vazhdon arsyetimi i kolegjit civil, janë deklarative dhe do të vlerësohen nga gjykata mbi tërësinë e të gjitha provave për të zgjidhur drejt çështjen. Në përfundim, kolegji civil vë detyrë që në rigjykimin e çështjes, gjykata duhet të vlerësojë të gjitha provat që janë të administruara në dosje si dhe të marrë të gjitha provat që pretendojnë palët, me qëllim që të arrijë në përfundim të drejtë e ligjor.

Por, Gjykata e Apelit Tiranë, në rigjykimin e çështjes nuk i ka zbatuar këto detyra të kolegjit civil, megjithëse sipas neneve 486 e 493 të Kodit të Procedurës Civile, ato kanë qenë të detyrueshme për zbatim. Nga vendimi i gjykatës së apelit dhe procesverbali i seancës i datës 15.11.1996, rezulton se në rigjykimin e çështjes nuk janë zbatuar rregullat procedurale të shqyrtimit në shkallët e parë, por është bërë një gjykim formal si shkallë e dytë. Në raste të kësaj natyre, Gjykata e apelit, që gjykon si shkallë e parë, duhej të dëgjonte palët, të merrte provat e nevojshme dhe të bënte vlerësimin e tyre në përputhje me rregullat procedurale të parashkuara në shkallë gjykimi.

Shkeljet e mësipërme e bëjnë procesin të parregullt, në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës.

Edhe vendimet e mëvonshme, si ai i kolegjit civil dhe i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet mospranimit pa të drejtë të rekursit dhe lënies në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, janë antikushtetuese. Meqenëse vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, ishte rrjedhojë e një procesi gjyqësor të parregullt, këto kolegje si instanca më të larta, duhej të mbanin qëndrim të drejtë e ligjor për prishjen e vendimit dhe jo për mospranimin e rekursit.

Vendimet e gjykatave të përmendura në objektin e kërkesës të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, duhet të shfuqizohen si antikushtetuese dhe çështja të dërgohet në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, në bazë të orientimeve të këtij vendimi, të zhvillojë një proces gjyqësor të rregullt, duke garantuar të drejtat kushtetuese të secilës palë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.12, datë 15.12.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.773, datë 2.6.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.P-1, datë 9.2.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

2. Çështja t’i dërgohet për shqyrtim Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 7.12.2000
Nr.41 i Regj.Themeltar
Nr.88 i Vendimit

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa duhet të rrëzohej për këto arsye:

1. Në kërkesë, si fakte për "proces të parregullt" gjyqësor ngrihet se kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit dhe Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë vendimet i kanë dhënë në Dhomë Këshillimi, dhe se nuk kanë shqyrtuar themelin e çështjes d.m.th., "bazueshmërinë e vendimit të gjykatës së apelit në ligj e në prova".

Pasi ngrihet më lart, pakica mendon se në rastin konkret, jo vetëm se nuk mund të flitet për proces të parregullt në kuptim të neneve 42 e 131 të Kushtetutës, por as edhe për shkelje të zakonshme procedurale. Në bazë të dispozitave procedurale, si kolegji civil në Dhomën e Këshillimit ashtu dhe kolegji seleksionues, bëjnë shqyrtimin paraprak të rekurseve, nëse ato përmbajnë shkaqet që i lejon ligji dhe kurrsesi nuk merren me shqyrtimin e themelit të çështjes.

2. Si fakt tjetër për "proces të parregullt" pretendohet se gjykata e apelit nuk ka zbatuar detyrat e caktuara nga Gjykata e Kasacionit për të shqyrtuar si shkallë e parë çështjen d.m.th., për të marrë e vlerësuar provat e paraqitura nga palët dhe për të kërkuar sqarime prej tyre.

Pakica mendon se, edhe pse fakti i pretenduar qëndron, dhe se ai përbën shkelje të nenit 486 të Kodit të Procedurës Civile, kurrsesi nuk mund të pranohet si shkelje që e bën procesin gjyqësor të parregullt në kuptimin kushtetues, objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

Pakica ka mendimin e palëkundur se jo çdo shkelje me karakter procedural, pavarësisht nga pasojat për fatin e çështjes e për të drejtat e palëve nuk mund të përbëjë shkak për "proces të parregullt" në kuptim të neneve 42 e 131 të Kushtetutës. Një zgjerim i këtij koncepti do të çonte padrejtësisht në mënjanimin e kontrollit gjyqësor nga kontrolli kushtetues.

Në rastin në fjalë janë cënuar parime procedurale që kanë të bëjnë me hierarkinë gjyqësore, të cilat nuk mund të merren si "principe themelore të procesit civil", shkelja e të cilave me të drejtë mund të konsiderohet se e bën procesin "të parregullt.

ANËTAR
A.Karamuço

Tiranë, më 7.12.2000

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 3.1.2001
Doli nga shtypi më 4.1.2001

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 150 lekë